



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-410-33070

Me date 24.05.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e ne mbështetje te nenit 10 te Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, 01-Nr-016-20161 të datës 30.03.2021, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhën me pak se një (1) vit për Drejtorin për urbanizëm dhe planifikim, ne këtë përbërje;

- 1.1 Doruntina BYTYQI-----kryesuese
- 1.2 Elona KUÇI -----anëtare
- 1.3 Agron BAJRAKTARI -----anëtar

2. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit është që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhën me pak se një (1) vit, se a i përmbushin kushtet dhe kriteret konform Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, 01-Nr-016-20161 të datës 30.03.2021 dhe t'i rekomandojnë Drejtorit të Drejtorisë përkatëse për nënshkrimin e kontratës.

3. Mandati i anëtareve të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave është dy (2) vite.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe e shfuqizon vendimin 01-Nr-020-31488 të datës 03.06.2021.



Te njoftohet;
Drejtoria e urbanizmit
Komisioni
Arkiva

[Handwritten signature]
[Handwritten signature]
[Handwritten signature]